



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 219

Tiranë – E Mërkurë 25 Shkurt 2015

PËRMBAJTJA

Ligj nr. 181/2014
datë 24.12.2014

Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006,
“Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë
shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”.....

Faqe

12927



LIGJ
Nr. 181/2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9665, DATË 18.12.2006,
“PËR HUAMARRJEN SHTETËRORE,
BORXHIN SHTETËROR DHE
GARANCITË SHTETËRORE TË HUAS
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 2

Kuptimi i huamarrjes shtetërore

Huamarrja shtetërore është një veprimtari që realizohet nëpërmjet marrëveshjeve dhe instrumenteve, të cilat përmbajnë rregulla për të drejtat dhe detyrimet e palëve, kushtet dhe mënyrat, sipas të cilave shteti shqiptar siguron fonde nga një apo më shumë huadhënës dhe dispozita për shlyerjen e huave.”.

Neni 2

Në nenin 6 bëhet ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Menaxhimi i borxhit është veprimtaria shtetërore, qëllimi kryesor i së cilës është sigurimi i fondeve të nevojshme të huamarrjes, duke vlerësuar riskun dhe koston e tij, në këndvështrimin afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe zhvillimin e tregut të titujve të shtetit, nëpërmjet shtimit të instrumenteve të tij dhe zgjerimit të bazës së investitorëve.”.

2. Pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Ministri i Financave raporton çdo katër muaj në Kuvend, pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, për ecurinë e borxhit shtetëror dhe borxhit të garantuar të shtetit.”.

Neni 3

Në nenin 7, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) Për të financuar nevojat e njërive të qeverisjes vendore dhe të subjekteve të tjera, për qëllim të financimit të projekteve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 4

Në nenin 13 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Tejkalimi i kufizimeve, të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, nuk mund të cenohet palët e treta (huadhënësit ose mbajtësit e titujve të shtetit, si dhe personat, në favor të të cilëve shteti ka dhënë garanci shtetërore) dhe në asnjë rast nuk sjell si pasojë pavlefshmërinë e marrëveshjeve përkatëse të huamarrjes apo lëshimit të garancive shtetërore.”.

Neni 5

Titulli i kreut IV ndryshohet si më poshtë:

“Marrëveshjet për borxhin shtetëror dhe garancitë e huas”.

Neni 6

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Procedurat e negociimit dhe miratimit të marrëveshjeve, instrumenteve për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas

Ministria e Financave mban kontakte zyrtare të drejtpërdrejta me kreditorët për sigurimin e financimeve nëpërmjet kredive. Në rastet kur për financimin e një projekti, investim publik, merret kredi nga banka private, përzgjedhja e kreditorit bëhet nëpërmjet procedurave të përzgjedhjes, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Ministri i Financave negocion dhe vendos për kushtet thelbësore të kontratave të huas në emër



të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave.

Për kontratat e kredisë ose të garancisë që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose të Këshillit të Ministrave, Ministri i Drejtësisë, me kërkesë të Ministrit të Financave, lëshon një opinion ligjor, i cili vërteton se janë zbatuar të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, në kuadër të kontratës, dhe se kontratat janë të ligjshme e mund të hyjnë në zbatim me fuqi të plotë ligjore.

Këshilli i Ministrave miraton procedurat për nënshkrimin, lëvizimin dhe raportimin e huave, të kredive dhe garancive, në emër të Këshillit të Ministrave ose të Republikës së Shqipërisë.

Ministri i Financave ka të drejtë të lidhë kontrata të huamarrjes shtetërore apo të emetojë instrumente borxhi të brendshëm dhe të jashtëm për sa kohë respektohen kushtet e përcaktuara në ligjin për buxhetin vjetor përkatës. Ministri i Financave nuk mund të lidhë kontrata të huamarrjes shtetërore apo të emetojë instrumente borxhi të brendshëm dhe të jashtëm kur tejkalohe kufijtë e huamarrjes, të përcaktuar në ligjin për buxhetin vjetor përkatës. Në rast se lind nevoja të tejkalohe kufizimet e ligjit për buxhetin vjetor, miratimi i tyre bëhet vetëm nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Huamarrja dhe garancitë shtetërore të huas me anë të marrëveshjeve ndërkombëtare

Për qëllimet e këtij ligji, marrëveshje ndërkombëtare për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas konsiderohen ato marrëveshje që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë ose Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nga Ministri i Financave, me shtete ose organizata ndërkombëtare publike.

Procedurat e negocimit, nënshkrimit, miratimit dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për huat shtetërore dhe garancitë shtetërore të huas kryhen sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.

Ministri i Drejtësisë, me kërkesë të Ministrit të Financave, lëshon një opinion ligjor, i cili vë-

reton se janë zbatuar të gjitha dispozitat ligjore në fuqi, se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, në kuadër të marrëveshjes dhe se marrëveshjet janë të ligjshme e mund të hyjnë në zbatim me fuqi të plotë ligjore.

Neni 8

Në nenin 30, titulli ndryshohet si më poshtë:
“Huadhënia e të ardhurave të borxhit shtetëror”.

Neni 9

Titulli i kreut V ndryshohet si më poshtë:
“Këshilltarët, agjentët fiskalë dhe ndërmjetësit financiarë të borxhit shtetëror”.

Neni 10

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli ndryshohet si më poshtë:

“Emërimi i këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetësve financiarë të borxhit”.

2. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë:

“Ministri i Financave emëron këshilltarët, agjentët fiskalë dhe ndërmjetësit financiarë të borxhit shtetëror. Për qëllim të këtij neni, në përzgjedhjen e këshilltarëve, agjentëve fiskalë dhe ndërmjetësve të borxhit shtetëror nuk zbatohen rregullat e prokurimit publik. Kushtet dhe procedurat për emërimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 24.12.2014

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 42 lekë